



REPUBLIKA E SHQIPERISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

Nr. Prot.

Vlorë, më 13.07.2017

Vendim
Nr. 75, datë 13.07.2017

PËR FINANCIMIN E BOTIMEVE DHE PJESËMARRJES NË KONFERENCA
SHKENCORE TË STAFIT AKADEMIK TË UNIVERSITETIT "ISMAIL
QEMALI", VLORE

Në mbështetje të nenit **3**, pika **3**, shkronja **c**, nenit **38**, pika **1**, shkronja **k** në Ligjin 80/20 "Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë", Vendimit të Senatit Akademik, Nr. 07, datë 26.01.2017, Vendimit të Bordit të Administrimit, nr. 6, datë 31.03. 2017, Senati Akademik në mbledhjen e datës 13.07.2017

VENDOSI:

1. Të miratojë në parim propozimin e Zv/rektorit për Zhvillim Institucional dhe Komunikim dhe Zv/rektorit për Kërkimin Shkencor me nr. 811 prot., datë 06.06 2017 si më poshtë:
 - a) Shuma tek zëri i parashikuar në buxhet për botime dhe pjesëmarrje në konferenca t'u shpërndahet të gjithë pedagogëve të UV-së në mënyrë të barabartë për vitin kalendarik 2017.
 - b) Këtë shumë pedagogët mund ta përdorin për pagesën e *fee-s* (tarifës) së konferencës/botime/pagesën e biletave të udhëtimit dhe hotelit.
Kjo shumë nuk mund të shpenzohet më shumë se në masën 10% (dhjetë përqind) për konferenca ose botime brenda Shqipërisë (vetëm në ato tek lista e revistave që Ministria e Arsimit dhe Sportit të Shqipërisë do të propozojë) ose në rajon (Kosovë, Maqedoni, Mal i Zi). Shuma tjetër duhet të shpenzohet vetëm për konferenca ose botime në revista të BE-s, OECD-së dhe G-20.*
 - c) Për pedagogët që nuk e përdorin fondin për vitin kalendarik 2017, në vitin kalendarik 2018 shuma e ofruar të jetë 50% (pesëdhjetë përqind) më pak dhe nëqoftëse kjo nuk përdoret dhe në vitin kalendarik 2018, atëherë në vitin kalendarik 2019 të përjashtohen nga përfitimi i fondit.**

Detyrimet e përfituesve të fondit



REPUBLIKA E SHQIPERISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
SENATI AKADEMIK

- Pagesat do të kryhen në bazë të Vendimit Nr 870, datë 14.12.2011 "Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit", si dhe në bazë të Udhëzimit Nr. 22, datë 10.07.2013 'Mbi zbatimin e vendimit nr. 870, datë 14.12.2011 të Këshillit të Ministrave "Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit"'.
 - Të jenë autorë të parë.
 - Të kenë informuar të paktën 2 (dy) muaj para organizimit të konferencës (ose edhe më shpejt me qëllim pagesën e *fee*-s dhe biletave me vlerë sa më të ulët).
 - Të jenë të pranishëm në konferenca (Nuk lejohet pjesëmarrja apo prezantimi në distancë.).
 - Të shkruajnë brenda 2 (dy) javëve pas ardhjes së tyre një relacion të shkurtër mbi pjesëmarrjen e tyre në aktivitetin e zhvilluar.
 - Të përpiqen të vendosin marrëdhënie me kolegë dhe Universitete homologe.
 - Të deklarojnë (si 'Mirënjohje') në botim ose tek prezantimi që financimi i tyre kryhet nga Universiteti 'Ismael Qemali', Vlorë.

Nga përfitimi i këtij fondi përjashtohen:

- Pedagogë me kohë të pjesshme.
- Pedagogë që janë punësuar në vitin akademik 2016-2017 (do të marrin 50% të shumës vitin e parë).
- Pedagogë që kanë leje akademike.
- Pedagogë që kanë leje të tjera.
- Pedagogë që vazhdojnë studimet e doktoratës jashtë shtetit dhe nuk janë të angazhuar plotësisht në UV.
- Pedagogë që nuk kanë titullin "Doktor i Shkencave" (ose nuk janë duke vazhduar studimet e doktoratës).

Përfitimet

Në fund të vitit kalendarik, në çdo fakultet pedagogu me botimin më prestigjioz*** fiton dyfishin e fondeve vitin e ardhshëm.

* Përjashtohen nga ky detyrim vetëm pedagogët që kryejnë veprimtarinë e tyre kerkimore-shkencore në fushën e Albanologjisë.



REPUBLIKA E SHQIPERISË
UNIVERSITETI “ISMAIL QEMALI” VLORE
SENATI AKADEMIK

****** Nëqoftëse një pedagog nuk dëshiron të shpenzojë fondin për vitin kalendarik 2017, por dëshiron ta shpenzojë atë për vitin kalendarik 2018 (psh. në një konferencë me *fee* të lartë etj.) i jepet e drejta ta bëjë këtë vetëm nëqoftëse vë në dijeni, jo më vonë se data 30 shtator, Rektorin, si dhe Drejtorinë e Financës dhe Realizimit të Buxhetit.

******* Matja do të kryhet në bazë të Faktorit të Impaktit (Thomson Reuters) dhe numrit të citimeve që artikulli ka marrë.

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Administratori i Universitetit “Ismael Qemali”, Vlorë, Drejtoria e Financës dhe Realizimi të Buxhetit, Zv/rektori për Zhvillim Institucional dhe Komunikim dhe Zv/rektori për Kërkimin Shkencor.
3. Vendimit regjistrohet dhe arkivohet.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK
Prof. Dr. Roland ZISI

Ky dokument përpilohet në 3 (tri) kopje.